NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 26 tetor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) shqyrtoi çështje që lidhen me zhvillimin e kuadrit rregullator të sektorit të energjisë elektrike, komunitetet e energjisë së rinovueshme, mbrojtjen e klientëve fundorë, si dhe licencimin dhe administrimin e licencave të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në këtë sektor.

Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme

Bordi miratoi Rregulloren "Për rregullat dhe procedurat e regjistrimit, administrimit të regjistrit dhe pezullimit të statusit të Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme", si dhe "Marrëveshjen Tip për Anëtarësimin në Komunitetin e Energjisë së Rinovueshme".

Këto akte përcaktojnë procedurat për regjistrimin e komuniteteve, administrimin dhe përditësimin e regjistrit, njoftimin e ndryshimeve dhe pezullimin e statusit, si dhe standardizojnë kushtet bazë të marrëdhënieve ndërmjet komunitetit dhe anëtarëve të tij.

Mbrojtja e klientëve fundorë dhe ndryshimi i furnizuesit

Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", Bordi vendosi fillimin e procedurave për miratimin e rregullores "Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë" dhe të rregullores "Mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike".

Rregullorja për klientët në nevojë synon të përcaktojë procedurat dhe masat mbrojtëse që duhet të zbatohen përpara ndërprerjes së furnizimit, përfshirë njoftimin paraprak, mundësinë e shlyerjes së detyrimeve ose lidhjes së një plani pagese dhe mbrojtjen e posaçme të klientëve që përdorin pajisje mjekësore për mbështetjen e jetës.

Ndërsa rregullat për ndryshimin e furnizuesit synojnë të lehtësojnë procedurën për klientët fundorë, të rrisin transparencën dhe të mundësojnë administrimin elektronik të procesit, në përputhje me kërkesat e kuadrit të ri ligjor.

Përditësimi i kuadrit rregullator për licencat dhe autorizimet

Bordi vendosi fillimin e procedurave për miratimin e rregullave të reja që lidhen me heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimeve për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut ose aksionarit që kontrollon

interesat e tij dhe vendosjen e kuotave ose aksioneve si garanci, si dhe transferimin e aseteve nga të licencuarit.

Këto iniciativa synojnë përshtatjen e kuadrit rregullator me ligjin nr. 59/2026 dhe qartësimin e procedurave administrative, dokumentacionit dhe kritereve që zbatohen gjatë shqyrtimit të kërkesave nga ERE.

Modifikimi i licencës së shoqërisë "SPV BLUE 2" sh.p.k.

Bordi miratoi modifikimin e Aneksit A të licencës së shoqërisë "SPV BLUE 2" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke ndryshuar kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaik nga 50 MW në 100 MW.

Gjithashtu, Bordi njohu vijimin e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike të deklaruar nga shoqëria, me kapacitet energjetik total 300 MW, sipas kushteve të përcaktuara në vendim dhe kuadrit ligjor në fuqi.

Vendimi përcakton detyrimin që fuqia totale e injektuar në pikën e lidhjes me rrjetin të mos tejkalojë 100 MW, si dhe detyrimin për paraqitjen pranë ERE-s, brenda afatit 12-mujor të përcaktuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026, të aplikimit për licencimin e veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike.

Rishikimi i licencës së shoqërisë "Projeksion Energji" sh.a.

Bordi vendosi shfuqizimin e vendimit nr. 76, datë 07.11.2006, të ndryshuar me vendimin nr. 47, datë 18.04.2008, për licencimin e shoqërisë "Projeksion Energji" sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Rehovë", HEC "Treskë 1" dhe HEC "Çarshovë".

Vendimmarrja u mbështet në konstatimin se shoqëria nuk zotëron më të drejta pronësie apo përdorimi mbi këto vepra hidroenergjetike, të cilat përbëjnë objektin e licencës së saj. Për rrjedhojë, u vlerësua se nuk ekziston më baza faktike dhe juridike për vijimin e ushtrimit të veprimtarisë së licencuar nga ky subjekt.

Në të njëjtën kohë, Bordi u njoh me kërkesën e shoqërisë "BOGOVA 2025" sh.p.k. për kalimin në emrin e saj të licencës së prodhimit të energjisë elektrike për HEC "Treskë 1" dhe HEC "Rehovë". Kjo kërkesë do të ndiqet në një procedurë më vete, sipas përcaktimeve dhe afateve ligjore.

Çështje të tjera të licencimit dhe autorizimit

Në mbledhje u shqyrtuan gjithashtu kërkesa të subjekteve për ushtrimin e veprimtarive të licencuara dhe çështje që lidhen me administrimin e licencave dhe autorizimeve.

Ndër to përfshiheshin kërkesa e shoqërisë "SHPËRDHAZA - ENERGJI" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Arrëz", me kapacitet të instaluar 1,613 kW; kërkesa e shoqërisë "HYDROPOWER" sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike; ndryshimet në vendimin e licencimit të shoqërisë "Bushtrica 2017" sh.p.k. ; si dhe kërkesa e shoqërisë "EN.KU" sh.p.k. për autorizim për barrësimin e kuotave dhe aseteve në favor të "Banka OTP Albania" sh.a.

Gjithashtu, Bordi u njoh me informacionin mbi raportimin e garancive të origjinës për periudhën korrik–shtator 2026.

ERE vijon ushtrimin e funksioneve të saj në zbatim të legjislacionit në fuqi, me synim zhvillimin e kuadrit rregullator, administrimin e licencave dhe autorizimeve, funksionimin transparent të sektorit të energjisë elektrike dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të klientëve fundorë.

Vendimet e plota të Bordit të ERE-s janë të aksesueshme në faqen zyrtare të ERE-s dhe publikohen në Fletoren Zyrtare, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.